

VENDIM
Nr.62, datë 7.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË PËR
MAKINERITË DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGJINË ELEKTRIKE, TË
IMPORTUAR NGA KESH SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, pjesa I, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4, paragrafët:

“Personi i tatueshëm importues, për të përfituar nga skema e shtyrjes së pagesës, detyrohet të paraqesë pranë organeve doganore një garanci bankare, shuma e së cilës është e barabartë me shumën e llogaritur të TVSH-së, për importin e makinerive apo të pajisjeve” dhe

“Kjo garanci lirohet nga banka vetëm pasi personi i tatueshëm i paraqet bankës dokumentin e pagesës së TVSH-së, për llogari të degës së doganës përkatëse, dhe konfirmimin, me shkrim, nga kjo degë doganore”, shfuqizohen.

2. Pika 6 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha